



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut  
Opština Kacanik  
Municipal of Kacanik

01Nr. 400/01-8790/18  
Kaçanik, 30.03.2018

Në bazë të nenit 40.2(b) dhe (d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, të nenit 34.5 dhe 61 të Statutit të Komunës, si dhe nenit 56 të Rregullores për Punë të Kuvendit, Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e vet të mbajtur më datë 30 Mars 2018, mori këtë:

**V E N D I M**  
**PËR APROVIMIN E RAPORTIT VJETOR FINANCIAR**  
**PËR VITIN E PËRFUNDUAR ME 31 DHJETOR 2017**

1. Me këtë Vendim, Aprovohet Raporti 01Nr. 400/01-8790/2018- me tekstin e mëtejme “ Raporti Vjetor Financiar për vitin e përfunduar me 31 Dhjetor 2017, i hartuar nga Drejtoria për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim, sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik dhe Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë Nr.03/L-048.
2. Në Raportin Vjetor Financiar të përcaktuar si në pikën 1. të këtij Vendimi, janë prezentuar Pasqyrat e pranimeve dhe pagesave të parave të gatëshme të Buxhetit të Përgjithshëm të Komunës së Kaçanikut, për periudhën 01.01.2017-31.12.2017 dhe i njëjti është pjesë përbërëse e këtij Vendimi.

**Me këtë Vendim njoftohen:**

1. Kryetari i Komunës,
2. Drejtoria për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim, dhe
3. Arkivi.



Kryesuesi i Kuvendit  
Kemal Mërseli



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut  
Opština Kaçanik  
Municipal Kaçanik

01.Nr. 06-350/01-3378/18  
Kaçanik, 30.03.2018

Në mbështetje të nenit 12.2 (d) lidhur me nenin 14.1 të Ligjit Nr. 03/L-040 - Për Vetëqeverisjen Lokale, të nenit 10.2 dhe 10.3 të Ligjit 02/L-26 –Për Tokën Bujqësore, të nenit 8 të Udhëzimit Administrativ Nr. 41/2006 –Për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore, të Propozim Vendimit të DUKMM 06 Nr. 350/01-3378/ 18 – Për Ndërrimin e Destinimit të Tokës Bujqësore në Tokë Ndërtimore të Parcela Kadastrale Nr. 01436-0–tokë bujqësore –Arë e Klasës së 3 (Tretë) në Zonën Kadastrale, Gllloboçicë, në pronësi të Adem S. Luma, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e vet të mbajtur me 30 Mars 2018, mori këtë:

#### V E N D I M

#### PARAPRAK PËR NDËRRIMIN E DESTINIMIT TË TOKËS

1. Me këtë Vendim, merret Vendim Paraprak -Për ndërrimin e destinimit të Tokës Bujqësore, në Tokë Ndërtimore.
2. Toka me destinim bujqësor e lejuar për ndërrimin e destinimit nga pika 1. e këtij Vendimi, lejohet në parcelën kadastrale **Nr. 01436-0** -tokë bujqësore – Arë e Klasës së 3 (Tretë) në sipërfaqe, **1573m<sup>2</sup>**, e evidentuara në certifikatën mbi të drejtat e pronës së paluajtshme **P-70917088-01436-0**, Zona Kadastrale Gllloboçicë, në pronësi të, Adem S. Luma, destinohet në Tokë Ndërtimore.
3. Kompensimi për ndërrimin e destinimit të tokës së përcaktuar si në pikën 2 të këtij Vendimi, do të paguhet në procedurë administrative, sipas dispozitave nënligjore në fuqi që e përcaktojnë ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore.
4. Para marrjes së vendimit përfundimtar për ndërrimin e destinimit të tokës së përcaktuar si në pikën 2 të këtij Vendimi, do të kërkohet, Pëlqimi nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.
5. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesën: Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrotjtje të Mjedisit si dhe Drejtoria për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Pylltari.
6. Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës -MAPL, si dhe 7 ditë pas publikimit në Faqen zyrtare të komunës.

**Me këtë Vendim njoftohen:** Kryetari i Komunës, Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrotjtje të Mjedisit- përmes kësaj drejtorie njoftohet pala dhe organet tjera relevante, Drejtoria për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Pylltari, Drejtoria për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim dhe Arkiva.

Kryesuesi i Kuvendit  
Kemal Mërseli





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova**  
**Republic of Kosovo**



**Komuna e Kaçanikut**  
**Opština Kacanik**  
**Municipal Kacanik**

**01Nr. 104/02-8895/18**  
**Kaçanik, 30.03.2018**

Në bazë të nenit 40.2 (d) e Ligjit nr. 03/L-040 -Për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare nr. 28/ 4 qershor 2008), të nenit 34.5 të Statutit të Komunës, si dhe nenit 56 të Rregullores për Punë të Kuvendit, Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e vet të mbajtur më datë: 30 Mars 2018, mori këtë:

**VENDIM**  
**PËR APROVIMIN E RAPORTIT TË EKZEKUTIVIT TË KOMUNËS PËR**  
**VITIN 2017**

1. Me këtë Vendim, Aprovohet Raporti 01Nr. 104/2-8895/2018 me tekstin e mëtejme “Raporti i Ekzekutivit të Komunës për vitin 2017” i hartuar nga Zyra e Kryetarit të Komunës.
2. Raporti si në pikën I. të këtij Vendimi, përmban pikësynimet në lidhje me realizimin e detyrave nga fushë veprimtaritë që janë në kompetencë të ekzekutivit të komunës (kryetarit të komunës dhe të drejtorive komunale) si dhe nivelin e realizimit të tyre për aktivitetin e zhvilluar për gjatë vitit 2017.
3. Raporti i ekzekutivit të komunës me numër të sipërshtënuar është pjesë përbërëse e këtij Vendimi.

**Me këtë Vendim njoftohen:**

1. Kryetari i Komunës,
2. Drejtoritë Komunale, dhe
3. Arkivi.

  
Kryesuesi i Kuvendit  
Kemal Mërseli



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova**  
**Republic of Kosovo**



**Komuna e Kaçanikut**  
**Opština Kaçanik**  
**Municipal Kaçanik**

01Nr. 60/01-10643/18  
Kaçanik, 30.03.2018

Kuvendi i Komunës Kaçanik, në bazë të nenit 40.2( a) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale lidhur me nenin 12.2, 12.3 dhe 12.4 të po këtij Ligji-Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28 /04 Qershor 2008), Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e vet të mbajtur me 30 Mars 2018, mori këtë:

**V E N D I M**  
**PËR INICIMIN E PROCEDURËS PËR NDRYSHIM PLOTËSIMIN E STATUTIT**  
**TË KOMUNËS 01 NR.3588/2008 I DATËS 25 SHTATOR 2008.**

1. Me këtë Vendim, Inicohet procedura për Ndryshim-Plotësimin të Statutit të Komunës së Kaçanikut 01 NR.3588/2008, aprovuar nga Kuvendi i Komunës më datë:25.09.2008.
2. Ndryshim plotësimet e Statutit të Komunës do të bëhen në pajtim të plotë me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, Rregulloren e MAPL-Për Procedurën e Hartimit dhe Publikimin e Akteve të Komunës, si dhe ligjeve dhe akteve tjera të cilat janë në kompetencë të Kuvendit të Komunës.
3. Procedurat e Ndryshim-plotësimin të Statutit të Komunës do të bëhen nga një Komision i cili do të formohet nga Kuvendi i Komunës, i cili komision do t'i udhëheqë të gjitha procedurat e ndryshimeve të Statutit të Komunës deri me miratimin final nga Kuvendi i Komunës.
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës të MAPL, si dhe 7 ditë pas publikimit në Faqen Zyrtare të Komunës.
5. Me këtë Vendim njoftohen: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Administratës së Përgjithshme, Zyra Ligjore dhe Arkivi.



Kryesuesi i Kuvendit  
Kemal Mërsel





Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut  
Opština Kacanik  
Municipal Kacanik

01.Nr. 06-350/01-39079/18  
Kaçanik, 30.03.2018

Në mbështetje të nenit 12.2 (d) lidhur me nenin 14.1 të Ligjit Nr. 03/L-040 - Për Vetëqeverisjen Lokale, të nenit 10.2 dhe 10.3 të Ligjit 02/L-26 –Për Tokën Bujqësore, të nenit 8 të Udhëzimit Administrativ Nr. 41/2006 –Për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore, të Propozim Vendimit të DUKMM 06 Nr. 350/01-39079/ 18 – Për Ndërrimin e Destinimit të Tokës Bujqësore në Tokë Ndërtimore të Parcela Kadastrale Nr. 600-2–tokë bujqësore –Mal i Klasës së 2 (Dytë) në Zonën Kadastrale, Bajnicë, në pronësi të “Green Hill” SH.P.K, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e vet të mbajtur me 30 Mars 2018, mori këtë:

#### V E N D I M PARAPRAK PËR NDËRRIMIN E DESTINIMIT TË TOKËS

1. Me këtë Vendim, merret Vendim Paraprak -Për ndërrimin e destinimit të Tokës Bujqësore, në Tokë Ndërtimore.
2. Toka me destinim bujqësor e lejuar për ndërrimin e destinimit nga pika 1. e këtij Vendimi, lejohet në parcelën kadastrale **Nr. 600-2** -tokë bujqësore (pyjore) Mal i Klasës së 2 (Dytë) në sipërfaqe, **997 m<sup>2</sup>**, e evidentuara në certifikatën mbi të drejtat e pronës së paluajtshme **P-70917002-01436-0** Zona Kadastrale, Bajnicë, në pronësi të, “Green Hill” Sh.P.K, destinohet në Tokë Ndërtimore.
3. Kompensimi për ndërrimin e destinimit të tokës së përcaktuar si në pikën 2 të këtij Vendimi, do të paguhet në procedurë administrative, sipas dispozitave nënligjore në fuqi që e përcaktojnë ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore.
4. Para marrjes së vendimit përfundimtar për ndërrimin e destinimit të tokës së përcaktuar si në pikën 2 të këtij Vendimi, do të kërkohet, Pëlqimi nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.
5. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesën: Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit si dhe Drejtoria për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Pylltari.
6. Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës -MAPL, si dhe 7 ditë pas publikimit në Faqen zyrtare të komunës.

**Me këtë Vendim njoftohen:** Kryetari i Komunës, Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit- përmes kësaj drejtorie njoftohet pala dhe organet tjera relevante, Drejtoria për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Pylltari, Drejtoria për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim dhe Arkiva.

Kryesuesi i Kuvendit  
Kemal Mërseli



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut  
Opština Kačanik  
Municipal Kačanik

01.Nr. 104/02-8294/18  
Kaçanik, 30.03.2018

Në mbështetje të nenit 12.2 (h), 17 (r) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, nenit 4.3. të Ligjit për Teatrot nr. 04.L- 106, Rregullores nr. 04/2015 (MKRS) për Kushtet dhe Kriteret e themelimit të teatrove kombëtare dhe të teatrove të qyteteve, Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e vet të mbajtur me 30 Mars 2018, mori këtë:

**VENDIM**  
**PËR INICIMIN E PROCEDURËS PËR THEMELIMIN E TEATRIT TË QYTETIT TË**  
**KAÇANIKUT**

1. Me këtë Vendim, Inicohet procedura për themelimin e Teatrit të Qytetit të Kaçanikut, si institucion me status publik.
2. Procedurat e themelimit të teatrit do të zhvillohen sipas kriterëve të përcaktuara në Rregulloren nr. 04/2015 (MKRS) për kushtet dhe kriteret e themelimit të teatrove kombëtare dhe të teatrove të qyteteve, përkatësisht pas vlerësimit profesional të Komisionit të veçantë të Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi do të përkujdesen: Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës dhe Drejtoria e Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit.
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës të MAPL, si dhe 7 ditë pas publikimit në Faqen Zyrtare të Komunës.

**Me këtë Vendim njoftohen:**

1. Kryetari i Komunës;
2. Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës;
3. Drejtoria për Ekonomi Financa dhe Zhvillimit; dhe
4. Arkivi.

Kryesuesi i Kuvendit  
Kemal Mërseli







Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut  
Opština Kaçanik  
Municipal Kaçanik

01Nr. 104/02-9727/18  
Kaçanik: 30.03.2018

Në bazë të nenit 55 të Rregullores për Punë të Kuvendit, në çështjen e shqyrtimit të Draft Planit të Aktiviteteve të Komitetit për Komunitete për vitin 2018, Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e vet të mbajtur më 30 Mars 2018, mori këtë:

**VENDIM**  
**PËR APROVIMIN E PLANIT TË AKTIVITETEVE TË KOMITETIT PËR**  
**KOMUNITETE PËR VITIN 2018**

1. Me këtë Vendim, Aprovohet Plani i Aktiviteteve të Komitetit për Komunitete , për vitin 2018, i propozuar nga Komiteti për Komunitete.
2. Në Planin e Aktiviteteve të Komitetit për Komunitete për vitin 2018, janë paraqitur objektivat e këtij Komiteti, arsyesh mëria e tyre, adresimi, përkrahja e nevojshme dhe koha e implementimit të aktiviteteve.
3. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është : Plani i Aktiviteteve të Komitetit për Komunitete për vitin 2018, i përmbledhur në gjithsej, 2 faqe.
4. Për realizimin e Planit të Punës së Komitetit për Komunitete do të kujdeset; Komiteti për Komunitete dhe organet tjera relevante të komunës.

Me këtë Vendim njoftohen: Kryetari i Komunës, Komiteti për Komunitete dhe Arkiva.

Kryesuesi i Kuvendit  
Kemal Mërseli





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova**  
**Republic of Kosovo**



**Komuna e Kaçanikut**  
**Opština Kacanik**  
**Municipality Kacanik**

**01 Nr. 104/02-9369/18**  
**Kaçanik, 30.03.2018**

Në bazë të nenit 12.1 dhe 12.2(d) lidhur me nenet 40.1 dhe 40.2 të Ligjit Nr. 03/L-040 -Për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), të nenit 6 të Udhëzimit Administrativ Nr. 27/2012 MPB 03/2012 MAPL, për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi, Kuvendi i Komunës Kaçanik, mbledhjen e vet të mbajtur me 30 Mars 2018, mori këtë:

**VENDIM**  
**PËR APROVIMIN E PLANIT TË PUNËS I KËSHILLIT KOMUNAL PËR**  
**SIGURI NË BASHKËSI PËR VITIN 2018**

1. Me këtë Vendim, Aprovohet Plani 01Nr. 104/02-9369/18 , më tekstin e mëtejme: “Plani i Punës i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2018” i hartuar nga KKSBB.
2. Plani i Punës si në pikën 1. të këtij Vendimi përmban; pikësynimet në lidhje me objektivat nga fushë veprimtaritë që janë në kompetencë të KKSBB, nivelin e realizimit të tyre, dhe numrin e takimeve për gjatë vitit 2018.
3. Plani i Punës së KKSBB, përmban gjithsej 5 faqe dhe i njëjti është pjesë përbërëse e këtij Vendimi.

**Me këtë Vendim njoftohet:** Zyra e Kryetarit të Komunës- përmes saj njoftohen anëtarët e KKSBB dhe Arkiva.

Kryesuesi i Kuvendit  
Kemal Mërseli







**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova**  
**Republic of Kosovo**



**Komuna e Kaçanikut**  
**Opština Kaçanik**  
**Municipal Kaçanik**

**01Nr. 104/02-9212/18**  
**Kaçanik, 30.03.2018**

Në bazë të nenit 12.2 pika (a), nenin 40.2 pika (e), të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, të nenit 12.2 të Statutit të Komunës së Kaçanikut, të Propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës të miratuar me datë, 25.09.2008, Kuvendi i Komunës së Kaçanikut në mbledhjen e mbajtur me 30 Mars 2018, mori këtë:

**VENDIM**  
**PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR NDRYSHIM- PLOTËSIMIN E STATUTIT TË**  
**KOMUNËS SË KAÇANIKUT**

1. Me këtë vendim, formohet komisioni për ndryshim plotësimin e Statutit të Komunës së Kaçanikut, në përbërje prej 7 anëtarëve; katër (4) anëtarë do të jenë nga Kuvendi i Komunës, dy (2) anëtarë nga ekzekutivi i Komunës dhe një (1) anëtar ekspert nga shoqëria civile, si vijon:
  - 1.1. Besim Vishi anëtar i KK nga PDK;
  - 1.2. Shpend Krusha anëtar i KK nga LVV;
  - 1.3. Arlinda Rakoci-Raka anëtare e KK nga LDK ;
  - 1.4. Shemsedin Luzha anëtar i KK nga AAK;
  - 1.5. Festim Neziraj drejtor i DAP ;
  - 1.6. Ilir Lumi Zyrtar Ligjor i Komunës ;
  - 1.7. Daut Rudi ekspert( avokat) nga OJQ
2. Detyrat dhe përgjegjësitë e komisionit janë:
  - 2.1. Zgjedhjen e Kryesuesit nga radhët e veta;
  - 2.2. Të zhvilloj procedurat të hartimit të draftit për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës së Kaçanikut të datës 25.09.2008, në pajtim të plotë me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, Rregulloren e MAPL Për Procedurën e Hartimit dhe Publikimin e Akteve të Komunës, si dhe ligjeve dhe akteve tjera të cilat janë në kompetencë të Kuvendit të Komunës;
  - 2.3. Të jep autorizime për njësitë komunale si Zyra Ligjore e Komunës, Njësisë për Integritet Evropian dhe Njësisë Buxhetore të Komunës rreth ligjshmërisë apo arsyeshmërisë të ndryshimeve në statut.
  - 2.4. Të organizoj dëgjim publik lidhur me propozimet për ndryshim në Statutin e Komunës, duke konsultuar grupet e ndryshme të interesit dhe qytetarëve.
3. Komisioni duhet t'i raportoj Kuvendit të Komunës për ecurinë e procesit dhe për punët e tij.
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës të MAPL, si dhe 7 ditë pas publikimit në Faqen Zyrtare të Komunës.
5. Me këtë Vendim njoftohen: anëtarët e Komisionit, Kryetari i Komunës, drejtorja e Administratës së Përgjithshme, drejtorja për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim dhe Arkivi.

Kryesuesi i Kuvendit  
Kemal Mërseli



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova**  
**Republic of Kosovo**



**Komuna e Kaçanikut**  
**Opština Kaçanik**  
**Municipal Kaçanik**

01Nr. 104/02-8499/18  
Kaçanik, 30.03.2018

Në bazë të nenit 12. të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, të nenit 8 pika 1. e Ligjit Nr. 04/L-144 për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës, të nenit 2 të Rregullores së QRK Nr. 23/2003- për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës, të propozim Vendimit të kryetarit të Komunës 01Nr. 104/02-8499/18 prej datës 16.03.2018, Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e mbajtur me 30 Mars 2018, mori këtë:

#### **VENDIM**

#### **PËR FORMIMIN E KOMISIONIT VLERËSUES PËR DHËNIEN NË SHFRYTEZIM TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS**

1. Me këtë vendim, të formohet komisioni vlerësues për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës në përbërje prej 7 anëtarëve; prej tyre tre (3) anëtar propozohen nga Kryetari i Komunës nga radhët e ekzekutivit të Komunës, tre (3) anëtar propozohen nga Kuvendi i Komunës nga radhët e anëtarëve të Kuvendit dhe një (1) anëtar ekspert nga shoqëria civile, dhe ky komision ka këtë përbërje;

- |                       |                                |
|-----------------------|--------------------------------|
| 1.1. Kadri Krivenjeva | anëtar i KK nga PDK;           |
| 1.2. Kaltrina Tafili  | anëtar i KK nga LVV;           |
| 1.3. Besnik Salihu    | anëtar i KK nga LDK            |
| 1.4. Hidajete Guri    | nga Ekzekutivi i Komunës;      |
| 1.5. Remzi Shabani    | nga Ekzekutivi i Komunës;      |
| 1.6. Zylfi Koxha      | nga Ekzekutivi i Komunës; dhe  |
| 1.7. Zekirja Elezi    | nga OJQ, ekspert i kadastrave. |

2. Detyrat dhe Përgjegjësitë e komisionit vlerësues janë:

- 2.1. Zgjedhjen e kryesuesit nga radhët e veta;
- 2.2. Përpilimin e njoftimit publik me të dhënat për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës në afat të shkurtë dhe afat të gjatë;
- 2.3. Prezenca në ankand publik (hapjen publike të ofertave), vlerësimi final i ofertave ekonomike më të favorshme në pajtim me kriteret e përcaktuara me njoftimin për ankand publik dhe shprehje të interesit;
- 2.4. Dërgimin e ofertës së përzgjedhur për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë për miratim të Kryetari i Komunës dhe në Kuvendin e Komunës, dhe çështje tjera të cilat konsiderohen të rëndësishme nga komisioni vlerësues i ofertave.

3. Organet relevante të administratës dhe njësitë tjera të organeve të saja, do t'i ofrojnë përkrahje Komisionit Vlerësues të Ofertave.

4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit dhe Drejtoria e Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit.

5. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës të MAPL, si dhe 7 pas publikimit në Faqen Zyrtare të Komunës.

**Me këtë Vendim njoftohen:** Anëtarët e Komisionit, Kryetari i Komunës, Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtoria e Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit dhe Arkivi.

Kryesuesi i Kuvendit  
Kemal Merseli